



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. _____ Prot.

Datë, 28/05/2024

UDHËZIM PËR VËZHguesIT

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”, datë 10.02.2020, neni 4 pika 16, neni 7 pika 8 dhe neni 10; paragrafi i parë lidhur me të drejtat dhe detyrat e vëzhguesve, KIZ-i UT-së:

UDHËZON:

1. Çdo kandidat/e i/e vetëkandiduar për autoritet drejtues dhe Senatin Akademik të UT-së ka të drejtë të caktojë 1 (një) vëzhgues në KZF dhe në KQV dhe për çdo tavolinë në vendin e numërimit të votave, pas regjistrimit të kandidatit/es në procesin zgjedhor.
2. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga personeli akademik duhet të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë, në Njësitë kryesore të UT-së.
3. Vëzhguesit e kandidatëve që vijnë nga studentët duhet të jenë studentë të Njësisë kryesore përkatëse të UT-së.
4. Kandidatët për autoritete drejtuese dhe Senatin Akademik të UT-së duhet të dërgojnë në mënyrë elektronike listën për caktimin e vëzhguesve të tyre pranë KZF/KQV-së, në adresën elektronike: kizut2021@unitir.edu.al, brenda datës 11.06.2024, ora 12:00.



5. Vëzhguesit nga organizata joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias, duhet të dërgojnë në mënyrë elektronike në adresën: kizut2021@unitir.edu.al, brenda datës 11.06.2024, ora 12:00, kërkesën për t'u akredituar si vëzhgues,
6. Vëzhguesit duhet të paraqiten pranë zyrës së KIZ-it të UT-së, më datë 14.06.2024, nga ora: 10:00 deri në orën 14:00, për t'u pajisur me autorizimin e akreditimit, duke paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Kërkesë për t'u akredituar si vëzhgues (sipas formatit bashkëlidhur);
 - b) Fotokopje të kartës së identitetit;
 - c) Një fotografi;
 - d) Vërtetim nga zyra e Burimeve Njerëzore të Njesisë kryesore përkatëse të UT-së për vëzhguesit nga anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë të UT-së.
 - e) Vërtetim studentit nga Degët e Sekretarive Mësimore të Njësive kryesore të UT-së dhe në Filialin e Sarandës, për vëzhguesit nga studentët.
 - f) Vërtetim nga zyra e Burimeve Njerëzore respektive për organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias.
7. KIZ akrediton vëzhguesit sipas listës së kandidatëve dhe shprehjes së interesit nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të specializuara dhe të angazhuara për mirëqeverisjen dhe demokratizimin, përfaqësues të ministrisë së linjës ose të medias, brenda datës 14.06.2024, ora 17:00.
8. Vëzhguesve u ndalohet rreptësisht prishja e qetësisë, filmimi dhe fotografimi gjatë procesit të votimit dhe të numërimit.
9. Në rast të shkeljes të standardeve etike, vëzhguesve u tërhiqet vëmendja publikisht. Në rast përsëritjeje, KIZ/KZF merr vendim për përjashtimin e vëzhguesit me shumicë votash.
10. Çdo vëzhgues i akredituar duhet ta mbajë dokumentin e akreditimit gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve deri në mbylljen e procesit të numërimit.
11. Vëzhguesit e akredituar duhet të zbatojnë detyrat e përcaktuara në nenin 10, të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës", datë 10.02.2020.



KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

1. Leticja Gusho
2. Arjan Tushaj
3. Alnida Koroshi
4. Eljon Doçe
5. Etlon Peppo
6. Shaniko Allajbeu
7. Dhurata Saraçi

(Kryetar)

(Anëtar)

-//-

-//-

-//-

-//-

-//-

